

Manual Perdorimi Sherbimi Bankar Dixhital

Intesa Sanpaolo Bank Albania

Permbajtja

1.	Informacion i pergjithshem.....	4
1.1	Sherbimi Bankar Dixhital.....	4
1.2	Kushtet per perdorimin te sherbimit.....	4
1.3	Informacioni teknik	4
1.4	Siguria.....	4
1.4.1	Çfare ofron sherbimi bankar dixhital	4
1.4.2	Çfare duhet te besh per minimizuar rreziqet	5
2.	Hapat e pare	6
2.1	Instalimi i aplikacionit	6
2.2	Regjistrimi ne aplikacionin mobile	6
2.3	Logimi/Hyrja ne aplikacionin ne celular.....	7
2.4	Logimi/Hyrja ne web (responsive).....	7
2.5	Aktivizimi i sherbimit #withSIGN (Firma e kualifikuar elektronike)	7
3.	Prelogin and Dashboard	8
3.1	Faqja perpara logimit – Aplikacioni mobile.....	8
3.1.1	Perdoruesit e paregjistruar	8
3.1.2	Perdorues te regjistruar	8
3.2	Funksioni #withPAY (e disponueshme vetem ne aplikacionin mobile).....	9
3.3	Funksioni #withCASH.....	9
3.4	#withKEY (ne aplikacionin mobile)	9
3.5	Faqja Kryesore.....	9
3.5.1	Llogaria rrjedhese kryesore	10
3.5.2	Karta e Kreditit	10
3.5.3	Kursimi kryesor	11
3.5.4	Veprimet e fundit	11
3.5.5	Paguaj te preferuarit.....	11
3.5.6	Kembim valutor	12
3.5.7	Kredite e mia.....	12
3.5.8	Chat	12
4.	Menute.....	13

4.1	Vitrina Ime	13
4.2	Llogarite	13
4.3	Pagesa.....	13
4.3.1	Transfero ne llogarine time.....	13
4.3.2	Bej nje pagese	14
4.3.3	Lista e Perfituesve.....	16
4.3.4	Lista e pagesave	16
4.3.5	Rimbushje Celulari.....	16
4.3.6	Pagesa periodike	17
4.4	Kartat.....	17
4.4.1	Kartat e mia.....	18
4.4.2	Karta e re virtuale.....	18
4.4.3	Shlyerja e kartes	18
4.4.4	#withCASH.....	18
4.4.5	Eksploruesi i Kartave te Debitit.....	19
4.5	Kursimet.....	20
4.5.1	Permbledhja e kursimeve	20
4.5.2	Eksploruesi i kursimeve.....	20
4.6	Kredi	21
4.6.1	Kredite e Mia.....	21
4.6.2	Kredia e shpejte (per klient pagamarres prane ISPBA dhe dhe klient Jo - pagamarres).....	21
5.	Konfigurimet	23
4.6.3	Hyrja dhe Sigura	23
4.6.4	Njoftimet.....	23
4.6.5	Procedurat dhe Sherbimet.....	23
4.6.6	Informacion dhe kushtet	23
4.6.7	Pajisjet.....	23
4.6.8	Dokumentat e Mia	24
4.6.9	Aksesi i shpejte	24
4.6.10	Oferta ne Distance	24

1. Informacion i pergjithshem

1.1 Sherbimi Bankar Dixhital

Intesa Sanpaolo Bank Albania ofron sherbimin bankar digjital nepermjet aplikacionit per celular qe mund te shkarkohet per Android ne Play Store dhe per IOS ne App Store, si dhe nepermjet çdo kompjuteri duke vizituar faqen zyrtare www.intesasanpaolobank.al. Aplikacion celular eshte i optimizuar posaçerisht per aparatet smartphones.

1.2 Kushtet per perdorimin te sherbimit

Sherbimi mund te perdoret nga te gjithë individet qe kane nje llogari rrjedhese bankare me banken Intesa Sanpaolo Bank Albania dhe kane firmosur ne dege kontraten per sherbimin bankar dixhital si dhe kane marre kredencialet e regjistrimit.

Sherbimi Bankar Dixhital mund te perdoret:

- Nepermjet aplikacionit qe mund te shkarkohet ne pajisjet celulare nga Play Store per aparatet Android dhe App Store per aparatet iOS
- Nepermjet faqes web (responsive), duke aksesuar faqen zyrtare te bankes www.intesasanpaolobank.al dhe klikuar mbi "Login" nga cdo kompjuter, tablete apo pajisje celulare.

1.3 Informacioni teknik

Aplikacioni mobile mund te shkarkohet ne te gjithë telefonat qe perdorin Sistemet operative:

- Android 4.1 e siper (rezolucioni minimal i ekranit :480x800 pixels)*,
- iOS 14.0 e siper

Per instalimin, perdorimin dhe funksionimin e aplikacionit eshte e nevojshme lidhja me internetin (internetin e celularin tuaj ose wi-fi).

Per te perdorur sherbimin nepermjet kompjuterit tuaj, eshte e nevojshme lidhja me internetin dhe nje nga versionet e meposhtme te shfletuesve te internetit.

- Google Chrome 4.0x (ose me i ri)
- Mozilla Firefox 4.0x (ose me i ri)
- Internet Explorer 11x (ose me i ri).
- Opera 49 (ose me shume)
- EDGE

1.4 Siguria

1.4.1 Çfare ofron sherbimi bankar digjital:

Per te parandaluar aksesin e paautorizuar, nese nuk e perdorni per disa minuta aplikacioni do te mbyllet automatikisht dhe do te shfaqet ekrani i identifikimit. Keshtu qe do te duhet te hyni përsëri ne aplikacion duke vendosur pinin ose smart identification (skanim te fytyres ose shenje gishti).

Per arsye sigurie, aplikacioni shfaq nje tastiere virtuale per te futur kodin PIN. Aplikacioni perdor tastiere te çrregullt per te futur PIN-in. Ky riorganizim i rastesishem i tastieres rrit nivelin e sigurise.

Pasi vendos 3 here PIN-in gabim, aplikacioni behet inaktiv, duke siguruar mbrojtje ndaj aksesit te padeshiruar.

Asnje informacion ne lidhje me llogarite apo PIN-in tuaj nuk ruhet ne aparatin tuaj celular duke siguruar keshtu konfidencialitetin e plote te informacionit tuaj.

1.4.2 Çfare duhet te besh per te minimizuar rreziqet:

- Perdor nje lidhje te sigurt ne internet. Mos u lidh me rrjetet pa mbrojtje te Wi-Fi-se me origjine te panjohur.
- PIN-i duhet te kete 6 - 8 karaktere.
- Mos vendos si PIN-in tend daten e lindjes ose ndonje grup tjetër numrash qe eshte e lehte per tu identifikuar (111111, 123456) dhe qe eshte i lidhur me ty ne nje fare menyre.
- Te lutem ruaj konfidencialitetin e User ID-se dhe PIN-it tend. Sigurohu qe askush nuk te sheh kur ti vendos PIN-in, dhe ne asnje rrethane mos ja tregoni ate askujt. Nese dyshon se PIN-i eshte marre nga nje person i paautorizuar, ndryshoje ate menjehere. Nese pajisja celular eshte humbur ose eshte vjedhur, çaktivizo menjehere sherbimin duke telefonuar Call Center-in 08006000 +3550692080903 +35542276000 ose raporto ne nje nga deget tona me te aferta.
- Pasi te perfundosh transaksionet nepermjet aplikacionit gjithmon kliko "Log-out".
- Lutemi te mos e fikni funksionin e tastieres te riorganizuar te aplikacionit celular. Ky funksion eshte i dizenuar per mbrojtjen tende.
- Mos e modifik sistemin operativ te pajisjes celular dhe mos instalo ne pajisje asnje aplikacion me origjine te panjohur.


2. Hapat e pare

Per te perdorur aplikacionin mobile, duhet te shkarkosh aplikacionin nga dyqani perkates Play Store apo App Store.

Per te perdorur sherbimin ne web, nuk nevojitet asnje instalim. Mjafton lidhja me internetin dhe nje shfletues qe te permbushë kriteret e permendura me siper.

2.1 Instalimi i aplikacionit

- Hap Play store/App Store dhe kerko aplikacionin e Intesa Sanpaolo Bank Albania..
- Shkarko Aplikacionin duke ndjekur udhezimet perkatese.
- Perpara instalimit, sigurohu qe te kesh memorje te mjaftueshme ne celularin tend



Apple Store



Play Store

2.2 Regjistrimi ne aplikacionin mobile

- Hap aplikacionin nga aparati celular
- Kliko tek Regjistro llogarine time
- Skano kodin QR ose vendos manualisht pjesen e pare te kredencialeve te marra nga banka (8 shifra) te cilat jane nje here te perdorshme.
- Ne aparatin tend celular do te vije nje SMS me pjesen e dyte te kodit te regjistrimit i cili do te gjenerohet automatikisht.
- Nese vendosja e kodit te regjistrimit, rezulton e suksesshme, percakto nje PIN me 6-8 shifra
- Konfirmo PIN-in, i cili do te te ndihmoje te hysh ne aplikacion, te autorizosh pagesa etj. Gjithashtu nese aparati juaj lejon edhe menyre tjeter identifikimi si psh me shenje gishti ose skanim fytyre mund ti aktivizosh ne kete moment ose me vone duke vizituar seksionin Konfigurime.

- Percakto nje kod rekuperimi i cili do te te ndihmoje te rikuperosh profilin tend ne rast se nderron pajisjen e celularit ose fshin padashje aplikacionin. Kodi i rikuperimit mund te jete 6-te ose 8-te shifror.
- Aktivizo komunitetin #withPAY (i cili do te te ndihmoje te kryesh transfera te thjeshta dhe te shpejta drejt anetareve te ketij komuniteti). Ne rast se deshiron ta c'aktivizosh kete funksionalitet, mund ta besh kete ne seksionin Konfigurime.
- Personalizimi profilin tend duke vendosur nje foto dhe nje emertim. Keto mund ti vendosesh / ndryshosh edhe pasi ke perfunduar procesin e regjistrimit tek zona e Konfigurime.

2.3 Logimi/Hyrja ne aplikacionin ne celular

Pasi je regjistruar mund te hysh ne aplikacion ne celular nepermjet vendosjes manualisht te pin-it, me gjurme gishti ose me skanimin e fytyres, opsione te cilat mund ti perdoresh ne rast se ke lejuar perdorimin e tyre gjate regjistrimit. Keto menyra logimi biometrike jane te disponueshme per tu aktivizuar vetem ne pajisjet qe e lejojne nje funksion te tille

Metodat e identifikimit:

PIN-i: Nese je duke perdorur PIN-in si baze te identifikimit, duhet te sigurohesh qe eshte Pin-I qe ke vendosur kur ke aktivizuar sherbimin. PIN-I eshte nje seri numrash qe konstiston ne 6 – 8 shifra .

Identifikimi me shenje gishti*: Nese aparati yt celular e ofron kete menyre identifikimi ti mund ta aktivizosh ate edhe si menyre identifikimi per sherbimin Digital. Nepermjet kesaj menyre ti mund te hysh ne aplikacion, te autorizosh transaksione etj.

Identifikimi me face ID*: E njejta gje edhe per kete menyre identifikimi, pra nese aparati yt i telefonit e lejon kete forme identifikimi ti mund ta aktivizosh ate.

** Perdoret vetem ne pajisje specifike*

2.4 Logimi/Hyrja ne web (responsive)

Aksesimi dhe gjenerimi i te dhënave per tu loguar ne web kryhet nëpërmjet software token, gjenerohen te dhënat si ID-ja e perdoruesit dhe kodi njepedorimesh i gjeneruar. Software token qe eshte pjese e aplikacionit mobile.

- Zgjidh #withKEY nga faqja perpara hyrjes se aplikacionit mobile te Intesa Sanpaolo Bank
- Vendos PIN-in ose ID-ne biometrike
- Ne faqen zyrtare te bankes kliko mbi butonin Login, vendos ID-ne e perdoruesit dhe kodin njepedorimesh te gjeneruar nga #withKEY (software token).

2.5 Aktivizimi i sherbimit #withSIGN (Firma e kualifikuar elektronike)

#withSIGN ose ndryshe firma e kualifikuar elektronike te ofron mundesine e firmosjes se dokumentave online, per nga vlefshmeria e njejte me firmen e njome. Per perdoruesit te cilet aktivizohen per here te pare shfaqet si hap mandator gjate procesit te regjistrimit, per te tjere qe e kane sherbimin prej kohesh mund ta aktivizojne nen kategorine e “Konfigurimeve” ne me menyre qe te perfitojne aksesueshmeri ne produktet e lancuara se fundmi si: Kredia e Shpejte, Eksploruesi i kartave te debitit etj.

- Tek hapi final i regjistrimit te perdoruesit do te shfaqet “Konfiguro #withSIGN.
- Pasi keni lexuar pershkrimin e shkurter qe shpjegon se cfare eshte #withsign, per te vijuar procesin, kliko tek “Aktivizo”.

- Per lexuar te gjitha dokumentat kliko tek “Shiko dokumentacionin”.
- Lexo dhe prano te gjitha dokumentat qe lidhen me sherbimin.
- Ne fund te cdo dokumenti do te te shfaqet “E kuptova”. Kliko mbi ikone per te vazhduar me procesin.
- Pasi ke lexuar dhe pranuar te gjitha dokumentat Kliko tek “Firme” per t’i firmosur elektronikisht.
- Vendos kodin PIN te cilin e perdor dhe per te hyre tek app dhe kliko “OK” (ose perdor FaceID nese eshte i aktivizuar)
- Vendos kodin 6 shifror i cili te vjen me sms ne numrin e tel dhe kliko tek “Vazhdo”.
- Nese kodi validohet me sukses, procesi i aktivizimit te firmes se kualifikuar elektronike #withsign ka perfunduar me sukses.
- Nga ky moment do te jesh ne gjendje te firmosesh elektronikisht per produktet dhe sherbimet qe banka ofron perms sherbimit banker dixhital.
- Dokumentat e sherbimit #withSIGN do ti gjes ne seksionin Dokumentat e mia

3. Prelogin and Dashboard

3.1 Faqja perpara logimit – Aplikacioni mobile

Per te hapur Sherbimin Bankar Dixhital te Intesa Sanpaolo Bank Albania ne celularin tend duhet te klikosh ne ikonën e aplikacionit. Permbajtja qe shfaqet ne zonen para hyrjes eshte e ndryshme ne varesi te faktit nese perdoruesi eshte i regjistruar ose jo.

3.1.1 Perdoruesit e paregjistruar

- Zgjidh gjuhen (Shqip, Anglisht, Italisht)
- Zbulo aplikacionin
- Vendndodhjet e Atm-ve dhe degeve
- Kontaktet
- Perlllogaritja e kurseve te kembimit

3.1.2 Perdorues te regjistruar

Ekrani i Para-hyrjes per perdoruesit e regjistruar te mundeson sa vijon:

- Ndrysho gjuhen e aplikacionit
- Hyr ne aplikacion
- Shiko gjendjen e shpejte te llogarise (“Gjendjen e Shpejte” mund ta aktivizosh / çaktivizosh tek konfigurimet. Ajo te mundeson shikimin e gjendjes se llogarise kryesore pa qene nevoja te hysh ne aplikacion).
- Kontaktet e bankes, numrat e Call Center, adresa elektronike.
- Fshirja e profilit te perdoruesit
- #withPAY
- #withCASH
- #WithKEY
- Vendndodhjet e Atm-ve dhe degeve

3.2 Funkzioni #withPAY (e disponueshme vetem ne aplikacionin mobile)

Qellimi i funksionit: “Dergo”, “Merr” transfertat ndermjet anetareve e tjere te komunitetit #withPAY nga faqja e Para-hyrjes pa patur nevojë te hysh ne aplikacion. Kjo eshte e vlefshme vetem per personat ne listen tende te kontakteve te cilet jane pjese e ketij komuniteti.

Hapat e Pageses/Kerkeses per fonde:

- Kliko :Dergo/Kerko Para
- Zgjidh perfituesin tek fusha “Ke do te paguash?”(ku do ju shfaqet lista e te gjithë numrave tuaj te kontaktit te cilet jane pjese e ketij komuniteti).
- Vendos shumen qe deshiron te transferosh tek fusha e paracktuar
- Vendos pershkrimin tek fusha “Shto pershkrimin” ose përzgjidh nje nga opsionet
- Kliko “Pagua” nëse dëshiron te transferosh para nga llogaria personale, ose “Kerkese” nëse dëshiron nje shume specifike nga dikush qe e përzgjedh.

*Ne rast kur nisni nje kerkese per fonde ju vjen njoftimi nëse personi qe i bete kërkesën e ka pranuar apo refuzuar ate.

3.3 Funkzioni #withCASH

Qellimi i funksionit: Ky funksionalitet te mundeson te terheqesh para nga ATM-te e Bankes sone pa qene nevoja e perdorimit te kartes fizike por permes nje kodi qe gjeneron ne aplikacion apo web (responsive). Shumat qe mund te terheqesh jane: 1,000 Lek, 2,000 Lek, 5000 Lek, 10,000 Lek, 25,000 Lek.

Hapat per gjenerimin e kodit te terheqjes #withCASH:

- Kliko tek #withCASH
- Zgjidh karten nga e cila deshiron te terheqesh para, zgjidh Shumen dhe percakto kohen e vlefshmerise se kodit.
- Kliko vazhdo
- Memorizo kodin e gjeneruar ose shperndaje ate. Nese kodi nuk perdoret Brenda afatit te percaktuar atehere skadon dhe fondet mbeten te paprekura ne llogarine tuaj.
Shko tek nje ATM e Intesa Sanpaolo Bank Albania dhe ne fundin e ekranit, duhet te shtypesh butonin “Per terheqje parash permes Celularit shtypni kete buton”. Me pas fut kodin e gjeneruar nga aplikacioni dhe keshtu do te kesh mundesine te kryesh terheqjen vetem me dy klikime.

3.4 #withKEY (ne aplikacionin mobile)

Qellimi i funksionit: Nepermjet #withKEY ne aplikacionin mobile, gjenerohet nje kod 6-te shifror, nje perdorimesh me nje kohezgjatje te percaktuar (90 sekonda) i cili te ndihmon te hysh ne web (responsive).

Hapat per gjenerimin dhe perdorimin e kodit #withKEY:

- Ne faqen e hyrjes ne web (responsive) ne fushen “Emri i Perdoruesit” vendos ID-ne e perdoruesit
- Shtyp #withKEY ne faqen perpara hyrjes te aplikacionin
- Identifikohu duke perdorur nje nga metodat e identifikimit te percaktuara gjate regjistrimit
- Kodi #withKEY do te gjenerohet
- Ne fushen “Kodi i token #withKEY” ne faqen web, vendos kodin e gjeneruar #withKEY qe te shfaqet ne aplikacionin mobile
- Shtyp “Hyr”

3.5 Faqja Kryesore

Pas hyrjes ne aplikacion ose ne web (responsive) hapet faqja kryesore, ku shfaqet llogaria rrjedhese kryesore, llogaria kryesore e kursimit ose depozita me afat dhe karta e kreditit. Nese klienti nuk ka llogari/depozite kursimi ose karte krediti, keto faqe nuk shfaqen.

Rreshkit me gisht majtas ose djathtas ne aplikacion, ose perdor shigjetat ne web (responsive), per te kaluar nga llogaria rrjedhese kryesore ne karten e kreditit, etj.

Ne seksionin me poshte, shfaqen 5-se transaksionet me te fundit per secilen nga produktet e siper

permendura,

Seksioni që vijon është 'paguaj përfituesin e preferuar', ku nese ke percaktuar nje te tille mund te fillosh nje transferte drejt ketij perfituesi pa qene nevoja per te shkuar tek menuja perkatese.

Ne fund te faqes kryesore do te shfaqet kredia ose paradhenia bankare ne rast se ke nje te tille.

Detajet per çdo seksion te faqes kryesore jane si me poshte:

3.5.1 Llogaria rrjedhese kryesore

Eshte nje llogari e paravendosur automatikisht. Kjo llogari mund te ndryshohet nese klienti ka me shume se nje llogari rrjedhese:

- Ne faqen kryesore, duke klikuar tek menuja me tre pika qe ndodhen te shfaqura djathas lart dhe duke klikuar mbi 'Ndrysho Llogarine Kryesore.
- Duke shkuar tek Konfigurime – Proçedurat dhe Sherbimet – Pozicion i Pergjithshem

Te dhenat qe shfaqen ne lidhje me llogarine permbajne kryesisht:

Totali i disponueshem: Gjendja e vlefshme, e perdorshme e llogarise.

Gjendje: Gjendja e llogarise + fondet e bllokuara + fondet akoma te paautorizuara ne llogari.

Paradhenie e mbetur: Ne rast se keni paradhenie bankare jepet gjendja e mbetur e saj.

Paradhenie e miratuar: Ne rast se keni paradhenie bankare jepet shuma e miratuar e paradhenies

Fonde te bllokuara: ketu shfaqen transfertat me date valute te cilat behen te vlefshme ne nje date te caktuar ose veprimet me karta qe nuk jane reflektuar ende ne llogari.

3.5.2 Karta e Kreditit

Numri i kartes ose emertimi: Nese nuk eshte percaktuar nje emertim per karten, do te shfaqet numri i kartes. Vetem kater shifrat e para dhe kater te fundit jane te dukshme. Te tjerat jane te maskuara per arsye sigurie.

Te dhenat qe shfaqen ne lidhje me karten e kreditit permbajne kryesisht:

Totali i disponueshem: Gjendja e vlefshme, e perdorshme e kartes dhe monedha.

Grafiku: Tregon gjendjen e vlefshme te perdorshme te kartes dhe shumen e shenzuar.

Kreditit i miratuar: Shuma totale maksimale qe mund te perdoret

Shpenzimi: Shuma totale e perdorur.

Fonde te bllokuara: Veprimet qe nuk jane procesuar ende.

3.5.3 Kursimi kryesor

Mund të jete llogari kursimi ose depozite me afat. Ky kursim mund të ndryshohet:

- Në faqen kryesore, duke klikuar tek menuja me tre pika që ndodhen të shfaqura djathtë lart dhe duke klikuar mbi 'Ndrysho Llogarinë Kryesore
- Duke shkuar tek Konfigurime – Proçedurat dhe Sherbimet – Pozicion i Përgjithshëm

Të dhënat që shfaqen në lidhje me kursimin kryesor përmbajnë kryesisht:

Gjendja: Shuma totale e kursimit, përfshirë edhe interesin e akumuluar.

Kursimi Fillestar: Shuma fillestare e kursimit.

Fitimi: Fitimi në fund të periudhës së pagesës në bazë të normës së interesit.

3.5.4 Veprimet e fundit

Mundeson një pasqyre të 5 veprimeve të fundit të llogarisë kryesore rrjedhese, Kartës së kreditit dhe llogarisë kryesore të kursimit.

- Këto veprime kanë të dhënat e mëposhtme:
- Data - Në të cilën veprimi gjenerohet
- Lloji i veprimit – Terheqje, depozitim në ATM, Transaksionet POS, Të gjitha llojet e pagesave, etj
- Përshkrimi - Detajet e transaksionit
- Shuma dhe Monedha – Vlera në të cilën llogaria debitohet ose kreditohet dhe valuta e saj.

“Shiko të gjitha” të ridrejton tek faqja e detajeve të llogarisë ku shfaqen 10 veprimet e fundit.

Për të parë veprime me të hershme mund të klikosh mbi “Shiko më shumë”.

Përdor ikonën e filtrit për të gjetur veprimin e kërkuar. Gjithashtu në mënyrë grafike janë të paraqitura hyrjet dhe daljet e kryera në llogari në dy muajt e fundit.

3.5.5 Paguaj të preferuarit

Transfero fonde me dy hapa të thjeshtë. Fillimisht për ta patur të aksesueshem këtë mënyrë transferimi duhet të kesh të regjistruar të paktën një përfitues të cilin duhet të kesh klasifikuar si të preferuar. Kjo të mundeson të kryesh me lehtësi dhe shpejtesi transaksione me një përfitues me të cilin mund të kryesh shpesh transaksione. Këta përfitues mund të kenë llogari brenda edhe jashtë banke.

Në rast se deshiron të paguash përfituesin e preferuar nga faqja kryesore:

- Vëndos Shumën
- Përshkrimin
- Kliko Vazhdo
- Të shfaqet Faqja përmbledhese
- Kliko Paguaj
- Të shfaqet Faqja e autorizimit (vëndos PIN-in ose kodin #withKEY)
- Të shfaqet Faqja e konfirmimit të pagesës

Kur nuk ke një përfitues mund të klikosh tek “Shtë të preferuarin” dhe automatikisht hapet faqja në të cilën mund të kryesh regjistrimin e përfituesit duke ndjekur këto hapa:

- Emri i përfituesit

- Emertimi i perfituesit
- Shto llogarine bankare
 - o Numri i llogarise dhe Emri i bankes jane fusha te detyrueshme – per llogarite e bankave te tjera tek Numri i llogarise duhet futur IBAN - i
 - o Zgjidh nese kjo eshte llogari e besuar ose jo

3.5.6 Kembim valutor

Ne web (responsive) shfaqet ne fund te faqes kryesore.

Per te pare kursin e kembimit ne aplikacionin mobile, kliko mbi ikonen e levizshme me tre ura qe gjendet ne faqen kryesore.

3.5.7 Kredite e mia

Nese ke nje kredi ose paradhenie bankare, ne fund te faqes kryesore do te shfaqen detajet specifike sipas llojit te kredise qe ke. Nese ke me shume se nje produkt kredie mund te kalosh nga njeri tek tjetri. Ne varesi te llojit te kredise detajet qe do te shfaqen jane:

- Data e kontraktimit dhe data e skadimit ose Data e Maturimit
- Limiti i perdorur dhe Limiti ne dispozicion per Overdraftin
- Paraqitja Grafike dhe te dhenat e keshtit tjetet per Kredine Personale dhe Kredine Hipotekore

Klikimi tek “Detajet” te ridrejton tek faqja e detajeve te kredise ku mund te shohesh me shume detaje perfshire edhe veprimet, interesat dhe penalitetet per Overdraftin si dhe keshtet e paguara per Kredite Personale dhe Hipotekore.

3.5.8 Chat

Funksionaliteti I chat-it te jep mundesi per te biseduar online me koleget e Qenders se Kontaktit per pyetje ose paqartesi te ndryshme. Ikonen e chat-it mund ta gjesh ne faqen kryesore sapo hyn ne aplikacion, ose ne krye te listes se menuve ne krah te djathte (lehtesisht e identifikueshme nga ikona) kjo e vlefshme per aksesimin nga celulart. Sa I takon aksesimit te ketij opsioni nga kompjuteri ai gjendet ne faqen zyrtere te bankes www.intesasanpaolobank.al ne krah te djathte ne fund te ekranit.

Hapat si funksionin chati online.

1. Zgjidh kategorine e interesuar nga opsionet qe te paraqiten ne ekran.
2. Kliko butonin “FILLO”.
3. Bisedimi me agjentin.

Menjehere shfaqet agjenti I cili eshte online per te biseduar. Ne fund te ekranit eshte tastiera ku mund te shkruani duke klikuar “SEND” mesazhi shkon tek agjenti. Ky opsion te mudeson edhe opsionin e bashkangjitjes se materiale sipas rastit nese eshte e nevojshme.

4. Mbyllja e bisedes.

Kliko “End” nese deshiron te perfundosh biseden mbaron ose “Back” per tu kthyer pas.

4. Menute

4.1 Vitrina Ime

Ketu do te kesh mundesine te shikosh ofertat promovionale ne lidhje me produktet e reja qe mund te nxjerre banka ose oferta per produktet aktuale qe ju pershtaten me mire. Mund te zgjedhesh ndermjet seksioneve per te cilat interesohesh si llogari, karta, kursime, kredi dhe te mund te marresh informacionin per produktin qe te intereson si dhe te shprehesh interesin tend per oferta te caktuara.

Mund te hapesh nje depozite fare thjesht edhe duke klikuar mbi secilin produkt depozite qe te shfaqet.

Aplikimi per nje depozite hapat

- Zgjidh depoziten qe deshiron
- Kliko butonin "Merr"
- Zgjidh konfigurimet qe te pershtaten
- Verifiko te dhenat e vendosura
- Prano Kushtet e kontrates per depoziten bankare dhe autorizo hapjen e depozites permes elementit te sigurise

4.2 Llogarite

Ketu mund te gresh te grupuara listuara te gjitha llogarite rrjedhese (perveç llogarive te kursimit) qe zoteron.

Ne Tabin – *Personale*, do te te shfaqen te gjitha llogarite titullar i te cilave je vetem ti.

Ne Tabin – *Te tjera* do te te shfaqen te gjitha llogarite e perbashketa ku secili titullar ka te drejta perdorimi vec.

Ne kete hapshire jepet secila nga llogarite me detajet mbi *totalin e disponueshem*, *gjendjen*, *fondet e bllokuara* ne rast se ka, *numrin e llogarise* dhe *emrin e titullarit*. Nese te nevojitet me shume informacion lidhur me ndonjeren nga keto llogari shtyp "Detajet" per te shfaqur te renditura gjithe veprimet ne kete llogari gjithashtu dhe nje grafik me hyrjet dhe dalje te muajit aktual dhe atij te kaluar.

4.3 Pagesa

4.3.1 Transfero ne llogarine time

Ketu mund te kryesh veprime mes llogarive te tua ne Lek ose ne valute.

1. Faqja e vendosjes se te dhenave:

- Perzgjidh monedhen dhe perkatesisht edhe llogarine nga e cila deshiron te kryesh kalimin
- Zgjidh valuten e llogarine perfituese
- Vendos Shumen e veprimit e cila perkon e llogarine nga e cila do te kryhet pagesa (ne rast se valuat jane te ndryshme shfaqet edhe shuma ekuivalent ne monedhen e llogarise pritese)
- Vendos Pershkrimin - nese deshiron
- Kliko tek 'Ne kete date' nese deshiron qe veprimi te kryhet ne nje date tjeter te mevonshme.

2. Faqja permbledhese: shfaq te dhenat permbledhese te veprimit.

- Shfaqen te dhenat e vendosura/perzgjedhura me pare
 - o Llogaria e cila do te debitohet, titullari/et, numri i llogarise, valuta

- Shuma e veprimit, monedha (shuma ekuivalent ne valute ne rast kalimi mes monedhave te ndryshme), data
- Llogaria e cila do te kreditohet, titullari/et, numri i llogarise,
- Kliko mbi Shigjeten kthehu nese deshiron te kthehesh pas per te bere ndonje ndryshim te mundshem.
- Kliko Butonin "X" per ta mbyllur transaksionin
- Kliko mbi Ruaj nese deshiron ta ruash veprimin per ta ekzekutuar me vone
- Kliko Paguaj per te vazhduar
- Kliko me shume per tu shfaqur detajet si data pershkrimi dhe komisioni ne kete rast nuk ka, ne rast kalimesh mes monedhave te ndryshme shfaqet data dhe kursi i kembimit i perdorur.

3. Faqja e autorizimit:

- Vendos elementin e sigurise (PIN/#withKEY) per te kaluar ne hapin final te transfertes.

4. Faqja konfirmuese: Shfaq statusin e veprimit te sapokryer, referencen e veprimit dhe te dhena te tjera

- Kliko Pagese e re/Konvertim i ri per te kryer nje veprim tjeter te ngjashem
- Kliko Shiko Faturen per te pare detajet e veprimit te porsakryer (mund ta shkarkoni ne format PDF)
- Kliko Shperndaj detajet per ti derguar detajet elektronikisht
- Kliko Me shume detaje per te pare detajet e veprimit.

4.3.2 Bej nje pagese

Ne kete funksionalitet keni mundësi te kryeni pagesat per te gjitha tipologjitë dhe ne te gjitha valutat e ofruara nga banka.

Transfertat qe mund te kryeni si me poshte:

- Pagesa ne Lek/valute brenda bankes apo drejt nje banke tjeter
- Pagesa nderkombetare drejt llogarive me përfitues vendor ose te huaj, pagesa Swift ose jo Swift
- Pagesat SEPA- transfertat brenda Eurozone ne valutën Euro

1. Faqja e vendosjes se te dhenave:

- Zgjidh Llogarine e cila do te debitohet.
- Vendos numrin e llogarisë se perfituesit
- Vendos emrin e Emrin e sakte te perfituesit ose zgjidh nga lista e perfituesve duke klikuar mbi ikonon perkatese.
- Zgjidh monedhen ne te cilen do te kryesh veprimin
- Vendos shumen dhe kliko Vazhdo

Hapi pasardhës i vendosjes se te dhënave shfaqet ne varësi te llojit te pagese qe po kryeni:

- 1.1 Per nje pagese brenda vendit ne Lek kërkohet te vendoset
 - a. Përshkrimi i pagesës
- 1.2 Per nje pagese brenda vendi ne valute kërkohet te vendoset
 - a. Burimi i fondeve
 - b. Informacioni per përfituesin
 - c. Perzgjedhja e mbajtjes se komisioneve
 - d. Emri i bankës përfituese
 - e. Ngarkimi i dokumentave
- 1.3 Per nje pagese me jashtë/Swift
 - a. Informacioni i përfituesit
 - b. Swift Code

- c. Opsioni i përzgjedhjes se Pageses Urgjente
- d. Perzgjedhja e mbajtjes se komisioneve
- e. Rruga e përfituesit
- f. Kodi postar dhe qyteti
- g. Shteti i përfituesit
- h. Burimi i fondeve
- i. Ngarkimi i dokumentave

Shenim per dokumentat e bashkelidhur:

Formatet e suportuara te dokumentave jane: JPEG, CSV; XLS; DOC; PDF

Maksimumi %1\$s dokumenta, madhësia maksimale %2\$s MB.

Emri i dokumentit mund të përmbajë numra, germa dhe karakterin special _ . Hapësira dhe karaktere të tjera speciale si: * [;,> <^&*%\$] nuk lejohen.

*Ne rast pagese fature fiskale elektronike mund te aktivizoni opsionin qe shfaqet dhe te vendosni ID e faturës fiskale.

2. Faqja permbledhese: shfaq te dhenat permbledhese te veprimit qe jane plotesuar ne ekranet e meparshme

- Kliko tek Me shume detaje per te pare te dhena shtese
- Kliko mbi Shigjeten kthehu nese deshiron te kthehesh pas per te bere ndonje ndryshim te mundshem.
- Kliko Butonin "X" per ta mbyllur transaksionin
- Kliko Paguaj per te vazhduar

3. Faqja e autorizimit:

- Vendos elementin e sigurise qe te kerkohej per te kaluar ne hapin final te transfertes.

4. Faqja konfirmuese: Shfaq statusin e veprimit te sapokryer, referencen e veprimit dhe te dhena te tjera

- Kliko Pageze e re per te kryer nje veprim tjeter
- Kliko Shiko Faturen per te pare detajet e veprimit te porsakryer (mund ta shkarkoni ne format PDF)
- Kliko Shperndaj detajet per ti derguar detajet elektronikisht
- Kliko Me shume detaje per te pare detajet e veprimit.
- Kliko "Beje periodike" nëse dëshiron qe ta kryesh përsëri kete pageze

**Shenim*

Per pagesat "SEPA" hapat jane te njejte si me lart shpjeguar, ndryshimi i vetem qendron qe komisionet shfaqen automatikisht SHA pra nuk jane fushe e klikueshme. Gjithashtu eshte kusht qe llogaria e perfituesit te jete ne Euro (monedha e përzgjedhur) dhe shteti te jete brenda Euro zones.

Ne rastin kur kodi Swift nuk popullohet automatikisht, duhet te konsiderohet qe te jete 11 shifore bashke me tre "X" ne fund te tij.

4.3.3 Lista e Perfituesve

Ketu mund te ruash perfituesit me te cilet kryen shpesh transfertat per ta bere punen tende me te thjeshte dhe per te mos vendosur manualisht te dhenat e perfituesit sa here qe kryen transfertat drejt tij.

Mund te kryesh regjistrimin e perfituesit duke ndjekur keto hapa:

- Kliko mbi Perfituesin e Ri
- Vendos Emrin e perfituesit
- Shtu numrin e llogarit
- Titullarin e llogarit
 - o Zgjidh nese kjo eshte llogari e besuar ose jo

Fushat me lart jane te detyrueshme por ju keni mundësi te shtoni edhe te dhëna te tjera te përcaktuara por jo te detyrueshme.

4.3.4 Lista e pagesave

Ketu mund te gresh te listura te gjitha veprimet, e grupuara si me poshte:

- Per tu bere: transfertat te ruajtura per tu kryer ne te ardhmen
- Ne pritje: transfertat per tu kryer ne nje date te caktuar
- Te planifikuara: transaksione te cilat nuk kryhen derisa te vije data ne te cilen ato jane caktuar te kryhen.
- Te ekzekutuara: gjithe transfertat te cilat jane kryer me sukses.
- Te deshtuara: transfertat te cilat kane deshtuar per nje arsye te caktuar si p.sh vendosja gabim e te dhënave, ose arsye sigurie.

4.3.5 Rimbushje celulare

